



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:203611  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05875048

KPPP.nr.1517/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Daut Ternava B.I, me seli në Fushë Kosovë, rr. “Motrat Qiriazi”, kundër debitorit “Guri i Bekuar” SHPK, me seli në Hanin e Elezit, fshati Seqishtë duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.231/23 të datës 11.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 26.06.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Guri i Bekuar” SHPK, ashtu që Urdhri P.nr.231/23 i datës 11.08.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.231/23 të datës 11.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.01/2023 e datës 17.04.2023 dhe faturës nr.02/2023 e datës 17.04.2023, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrit, t’ia paguajë kreditorit borxhin 15,514.64 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas tarifës së përmbartuesve, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbauesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se urdhri përmbauesor ka të meta sepse propozimi për përmbauesor e ka datën 11.09.2023 ndërsa vulat e përmbauesit privat si në hyrje të dokumentit ashtu edhe në vulën e urdhrit mbajnë datën 11.08.2023, pra urdhri përmbauesor është dhënë 1 muaj para se të ushtrohet propozimi për përmbauesor. Tutje debitori ka shtuar se urdhri përmbauesor është në kundërshtim me nenin 37 të LPPP-së për arsye se dokumentet e besueshme që i ka bashkangjitur kreditori nuk janë origjinal përkatësisht nuk janë kopje të noterizuara por vetëm kopje të thjeshta. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj në tërësi Urdhrin Përmbauesor P.nr.231/23.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit, kreditori thekson se përmbauesi privat e ka caktuar përmbauesorin duke u bazuar në nenin 29 të LPPP-së, propozimi për përmbauesor është i bazuar në fatura të cilat debitori i ka pranuar në origjinal dhe afati i pagesës është si në faturë data 17.04.2023. Tutje kreditori ka shtuar se debitori prapësimin nuk e ka të bazuar në prova dhe qëllimi i vetëm i prapësimit ishte zvarritja e pagesës së borxhit. Kreditori ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe të vërtetoj Urdhrin Përmbauesor P.nr.231/23.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbauesorimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesorim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbauesorim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-

së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentet e besueshme: faturës nr.01/2023 e datës 17.04.2023 dhe faturës nr.02/2023 e datës 17.04.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimin të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1517/23, me datë 26.06.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.